



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.1.2025

Nr: 33

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË AGJENCISË
KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE, PËR PERIUdhËN 17 JANAR – 18
JANAR 2025**

Sot, më datë 24.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

- SUBJEKT:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
- OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për periudhën 17 janar deri më 18 janar 2025.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 17-18 janar 2025, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Tryezë diskutimesh, “Të drejtat e njeriut”, “Tryezë diskutimi e organizuar nga IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin në Shqipëri) mbi Migracionin dhe Diasporën

Data: 24.1.2025 Nr: 33
Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për periudhën 17 janar – 18 janar 2025”

në nivel vendor me pjesëmarrjen e Strukturave të Migracionit dhe Diasporës të 61 Bashkive, përfaqësues të zyrave vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 21.1.2025.

Nëpërmjet email-it të datës 22.1.2025, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 24.1.2025, ora 13:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Për shkak të raportimit për hërë të parë nga ana jonë, aktiviteti u raportua jashtë afatit. Ju vëmë në djeni se në nuk kemi qenë organizator dhe nuk kemi marrë pjesë në të si rezultat i statusit "ndaluar”.*

Referuar pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, parashikohet se raportimi në NRI për një veprimtari publike duhet të bëhet jo më vonë se 5 (ditë) përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Raportimi bëhet nga për veprimtari të cilat organizohen ose bashkëorganizohen nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, ka qenë në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI